



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
"ISUF GJATA"
KORÇË

Adresa :Lagja17
Rr: "Ajet Gjindolli"
Tel +355 82 25 0858

e-mail : shk_isufgjata@yahoo.com

Nr.74. Prot

Korçë më 09.09.2022

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele.

Drejtuar: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të ligjit Nr.15 / 2019 "Për nxitjen e punësimit", ligjit nr.15. datë 2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" Udhëzimit Nr.14, datë 27/05/2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional".

Ofruesi Publik I AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale "Isuf Gjata" Korçë, ju njofton shpalljen e vendit të lirë për pozicionin

- Mësimdhënës i praktikës profesionale në drejtimin Hoteleri-Turizem me kohë të pjeshme 12 orë/javë.

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik në shkollën e mesme Profesionale "Isuf Gjata" Korçë.

1.1.Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon :

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës të prerë për kryerjen e veprave penale .
- Te mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.
- Të demostrojë vlera të larta të etikës,sjelljes dhe komunikimit.
- Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit .

1.2. Aplikanti duhet të plotësojë **kriteret e posaçme** për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në shkollën e mesme profesionale "Isuf Gjata" Korçë si vijon :

- a) Te kete te paktën diploma nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjten fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-se, për të cilin po aplikon
- b) Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet.
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentat e aplikimit

- a) Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë
- b) Letërmotivimin për pozicionin.
- c) Jetëshkrimin (CV), sipas modelit Europass Curriculum Vitae
- d) Kartën e identitetit.
- e) Diplomën.
- f) Librezën e punës.
- g) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV.
- h) Certifikatë apo dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
- j) Vërtetim i gjendjes shëndetësore.
- l) Vërtetim i gjendjes gjyqësore .
- k) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka më masa disiplinore në fuqi.
- m) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm .

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës **21.09.2022**

Drejtoreshë shkollë

